



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Modelim

Niveli III në KSHK¹, referuar niveli III të KEK²

K-D3-III-24

Tiranë më, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbatja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
Kompetenca të përgjithshme.....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
D3-04-III-0087-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në modelim	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
D3-04-III-0088-24 Marrja e masave dhe përgatitja e kallëpeve.....	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	8
D3-04-III-0089-24 Zhvillimi i kallëpeve në masa të tjera.....	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	10
D3-04-III-0090-24 Njohuri mbi modën dhe estetikën.....	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
D3-04-III-0091-24 Realizimi i prototipit.....	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
D3-04-III-0092-24 Konfeksionimi i produktit.....	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
D3-04-III-0093-24 Kryerja e kontrollit të cilësisë	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
D3-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	13
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	14
	2

Kriteret e vlerësimit	14
D3-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	16
D3-04-III-0094-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit.....	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	17
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	17
Modalitetet e vlerësimit	17
Informacion shtesë	18
SHËNIM	18

Emërtimi i kualifikimit	Modelim			Kodi
Kohëzgjatja	1500 orë nacionale	Niveli	III në KSHK, referuar niveli III të KEK	K-D3-III-24
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikim profesional “Modelim”, niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, është të përgatisë modelistë të kualifikuar për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin dhe konfeksionimin e veshjeve, si dhe të zhvillojë individin, jo vetëm nga ana profesionale, por edhe personalitetin e tyre në mënyrë që të jetojnë në përshtatje me mjedisin që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në shkollat që ofrojnë kualifikim profesional në “Modelim” niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë përfunduar kualifikimin profesional “Tekstil-Konfeksion”, niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK,; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. – kanë aftësi të kufizuara, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtijshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Modelim”, niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të këtij niveli, si punonjës i kualifikuar në këtë fushë, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të veshjeve, në punishte të ndryshme artizanale dhe atelie mode apo të vetëpunësohet. Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, (menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2024			
Data e miratimit	(kur të miratohet)			
Variantet e mëparshme	D-II-03-14			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “Modelim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi duhet të zotërojë njësitë të të nxënës të mëposhtme:

Kompetenca të përgjithshme

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënës.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet.
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNËS TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënës (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

D3-04-III-0087-24 Planifikimi dhe organizimi i punës në modelim

Rezultatet e të nxënës në njohuri

1. Të përshkruajë mënyrat e organizimit të një atelieje;
2. Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
3. Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të veprimtarisë ditore, javore dhe mujore;
4. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të burimeve njerëzore;
5. Të përshkruajë rëndësinë dhe funksionin e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
6. Të shpjegojë mënyrën e kontrollit të funksionalitetit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;

7. Të shpjegojë radhën e punës në varësi të realizimit të produktit;
8. Të shpjegojë mënyrat e menaxhimit të skedarëve të kallëpeve;
9. Të argumentojë rëndësinë e ndarjes së detyrave në ekip;
10. Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit të pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve përkatëse;
11. Të shpjegojë mënyrat e raportimit të punës së kryer.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të organizojë një atelie;
2. Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
3. Të planifikojë veprimtaritë ditore, javore dhe mujore;
4. Të planifikojë burimet njerëzore;
5. Të kontrollojë funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas manualeve përkatëse;
6. Të përcaktojë radhën e punës në varësi të realizimit të produktit;
7. Të ndajë detyrat në ekip sipas proceseve.
8. Të menaxhojë skedarët e kallëpeve;
9. Të mbikëqyrë pastrimin dhe sistemimit të vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve përkatëse;
10. Të raportojë për punës e kryer.

Kriteret e vlerësimit

- Organizon një atelie, sipas funksionalitetit dhe trendit të kohët;
- Organizon vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Planifikon veprimtaritë ditore, javore dhe mujore, sipas nevojës dhe rregullores së brendshme;
- Kontrollon funksionalitetin e mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas manualeve përkatëse;
- Përcakton radhën e punës, sipas llojit të produktit dhe procesit të punës;
- Menaxhon burimet njerëzore, sipas proceseve të punës dhe kualifikimeve përkatëse;
- Raporton për punës e kryer, sipas formateve dhe rregullores së brendshme;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas manualeve përkatëse;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës, sipas rregulloreve të brendshme;

D3-04-III-0088-24 Marrja e masave dhe përgatitja e kallëpeve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e antropometrisë dhe anatomisë së trupit të njeriut;
2. Të shpjegojë mënyrën proporcionale të trupit të njeriut, në funksion të modelimit;
3. Të përshkruajë rëndësinë e lëvizjeve kryesore të trupit të njeriut, në funksion të modelimit;
4. Të përshkruajë zhvillimin e trupit të njeriut dhe pikat antropometrike për matjen e tij;
5. Të shpjegojë cilat janë llojet e defekteve të trupit të njeriut dhe rëndësinë e njohjes së tyre;
6. Të shpjegojë mjetet dhe instrumentet matëse, funksionimin dhe përdorimin e tyre;
7. Të përshkruajë teknikat e marrjes së masave;
8. Të shpjegojë llojet e tabelave të përmasave dhe mënyrat e përlogaritjes së tyre;

9. Të shpjegojë terminologjinë dhe informacionin në tabelat e përmasave;
10. Të shpjegojë sistemet e përmasave të veshjeve;
11. Të përshkruajë standardet e industrisë sipas llojit të veshjes.
12. Të listojë mjetet dhe teknikat përkatëse për modelim;
13. Të shpjegojë rëndësinë e njohjes së llojeve të pëlhurave, strukturës dhe vetive të tyre, (vijat drejtuese, ana e parme, pasme etj.);
14. Të përshkruajë teknikat e manipulimit të tekstit (palosje, ngjyrosje, qëndisje, rrudhosje etj.);
15. Të shpjegojë teknikat e realizimit të kallëpeve bazë 2 dhe 3 dimensionale (2D dhe 3D) për veshje për gra, burra, fëmijë (trupi, mëngët, pantallonat, fundi etj.);
16. Të shpjegojë teknikat e modifikimit të kallëpeve;
17. Të shpjegojë rëndësinë e zbrërthimit të modelit të veshjes nga figurina në skicë teknike;
18. Të shpjegojë mënyrën e zbrërthimit të një modeli në pjesë përbërëse;
19. Të përshkruajë rëndësinë e vizatimit skematik të veshjes, para dhe mbrapa;
20. Të përshkruajë skicën teknike të detajeve të veshjes (jaka, xhepi, pala, vrima, kopsa, zinxhiri, tegeli etj.);
21. Të shpjegojë teknikat e spostimit të pencave;
22. Të shpjegojë teknikat e realizimit të korseve të bustit;
23. Të shpjegojë llojet e supanjave dhe teknikat e krijimit të tyre;
24. Të shpjegojë llojet e dekolteve, jakave si dhe teknikat e realizimit të tyre;
25. Të shpjegojë llojet e xhepave dhe teknikat e realizimit të tyre;
26. Të shpjegojë llojet e qemerëve dhe teknikat e realizimit të tyre;
27. Të shpjegojë teknikat e krijimit të veshjeve reglan;
28. Të shpjegojë teknikat e krijimit të veshjeve kimono;
29. Të shpjegojë teknikat e krijimit të veshjeve të brendshme;
30. Të shpjegojë teknikat e përdorimit të kallëpeve të elementëve të veshjes për qëllim të astarëve dhe fortesave;
31. Të përshkruajë teknikën mulazh;
32. Të listojë llojet e manekinëve dhe pëlhurat për teknikën mulazh;
33. Të shpjegojë llojet, rëndësinë, funksionin dhe teknikat e përdorimit të shenjave orientuese.
34. Të shpjegojë teknikat e krijimit të fundit dhe fustanit;
35. Të shpjegojë teknikat e krijimit të bluzës dhe këmishës;
36. Të shpjegojë teknikat e krijimit të pantallonit;
37. Të shpjegojë teknikat e krijimit të xhaketës dhe palltos;
38. Të shpjegojë teknikat e krijimit të veshjeve të gjumit;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të ndajë në mënyrë proporcionale trupin e njeriut, në funksion të modelimit;
2. Të identifikojë llojet e defekteve të trupit të njeriut;
3. Të përdorë mjetet dhe instrumentet matëse;
4. Të zbatojë teknikat e marrjes së masave;
5. Të përdorë tabelat e përmasave;
6. Të zbatojë sistemet e përmasave të veshjeve;
7. Të respektojë standardet e industrisë sipas llojit të veshjes.
8. Të përdorë mjetet dhe teknikat përkatëse për modelim;

9. Të dallojë llojet e pëlhurave, strukturës dhe vetive të tyre, (vijat drejtuese, ana e parme, pasme etj.);
10. Të zbatojë teknikat e manipulimit të tekstilit (palosje, ngjyrosje, qëndisje, rrudhosje etj.);
11. Të zbatojë teknikat e realizimit të kallëpeve bazë 2 dhe 3 dimensionale (2D dhe 3D) për veshje për gra, burra, fëmijë (trupi, mëngët, pantallonat, fundi etj.);
12. Të zbatojë teknikat e modifikimit të kallëpeve;
13. Të zbërthejë modelin e veshjes nga figurina në skicë teknike;
14. Të zbërthejë një model në pjesë përbërëse;
15. Të kryejë vizatimin skematik të veshjes, para dhe mbrapa;
16. Të realizojë skicën teknike të detajeve të veshjes (jaka, xhepi, pala, vrima, kopsa, zinxhiri, tegeli etj.);
17. Të zbatojë teknikat e spostimit të pencave;
18. Të zbatojë teknikat e realizimit të korseve të bustit;
19. Të zbatojë teknikat e krijimit të supanjave;
20. Të zbatojë teknikat e krijimit të dekolteve dhe jakave;
21. Të zbatojë teknikat e krijimit të xhepave;
22. Të zbatojë teknikat e krijimit të qemerëve;
23. Të zbatojë teknikat e krijimit të veshjeve reglan;
24. Të zbatojë teknikat e krijimit të veshjeve kimono;
25. Të zbatojë/ e krijimit të veshjeve të brendshme;
26. Të zbatojë teknikat e përdorimit të kallëpeve të elementëve të veshjes për astarët dhe fortesat;
27. Të zbatojë teknikën mulazh;
28. Të përzgjedhë llojet e manekinëve dhe pëlkurat për teknikën mulazh;
29. Të dallojë llojet, funksionin dhe teknikat e përdorimit të shenjave orientuese;
30. Të zbatojë teknikat e krijimit të fundit dhe fustanit;
31. Të zbatojë teknikat e krijimit të bluzës dhe këmishës;
32. Të zbatojë teknikat e krijimit të pantallonit;
33. Të zbatojë teknikat e krijimit të xhakëtës dhe palltos;
34. Të zbatojë teknikat e krijimit të veshjeve të gjumit;

Kriteret e vlerësimit

- Ndan në mënyrë proporcionale trupin e njeriut, në funksion të modelimit;
- Identifikon saktë defektet në trupit e njeriut;
- Përdor mjetet dhe instrumentet matëse, sipas modelit;
- Merr masat duke zbatuar teknikat përkatëse;
- Përdor tabelat e përmasave, sipas specifikave;
- Respekton standardet e industrisë së modës, sipas llojit të veshjes.
- Përdor mjetet dhe teknikat përkatëse, sipas produktit të modelimit;
- Dallon pëlkurat dhe strukturën, (vijat drejtuese, ana e parme, pasme etj.), sipas llojit të saj;
- Zbaton teknikat e manipulimit, sipas llojit të tekstilit (palosje, ngjyrosje, qëndisje, rrudhosje etj.);
- Zbaton teknikat e realizimit të kallëpeve bazë 2 dhe 3 dimensionale (2D dhe 3D, sipas llojit të produktit;
- Zbaton teknikat e modifikimit të kallëpeve, sipas standardit;

- Zbërthen modelin e veshjes nga figurina, sipas skicës teknike;
- Zbërthen modelin në pjesë përbërëse, sipas skicës;
- Realizon skicën teknike, sipas detajeve të veshjes (jaka, xhepi, pala, vrima, kopsa, zinxhiri, tegeli etj.);
- Realizon spostimit të pencave, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon korsetë e bustit, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon supanjat, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon dekolletë dhe jakat, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon xhepat, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon qemerët, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon veshjet reglan, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon veshjet kimono, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon veshjet të brendshme, sipas teknikës përkatëse;
- Përdor kallëpe të elementëve të veshjes për astarët dhe fortesat, sipas teknikës përkatëse;
- Zbaton teknikën mulazh, sipas udhëzimeve;
- Përzgjedh manekinë dhe pëlhura për teknikën mulazh;
- Përzgjedh shenjat orientuese, sipas llojet dhe funksionit;
- Realizon fundin dhe fustanin, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon bluzën dhe këmishën, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon pantallonat, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon xhaketen dhe pallton, sipas teknikës përkatëse;
- Realizon veshjet e gjumit, sipas teknikës përkatëse;

D3-04-III-0089-24 Zhvillimi i kallëpeve në masa të tjera

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë mënyrën e realizimit të kallëpeve në letër/program;
2. Të përshkruajë rëndësinë e sistemit koordinativ;
3. Të përshkruajë rëndësinë e pikave antropometrike ku do të kryhet zmadhimi/zvogëlimi;
4. Të përshkruajë mënyrën e zhvillimit të zmadhimit/zvogëlimit të elementëve të kallëpeve në letër/program;
5. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e vendosjes së shenjave orientuese mbi kallëpet e zmadhuar/zvogëluar;
6. Të përshkruajë teknikat e transferimit të masave të modelit;
7. Të listojë pikat e lëvizshme dhe të palëvizshme gjatë zhvillimit të numrave;
8. Të analizojë grafikisht zhvillimin e numrave në skemën e prerjes;
9. Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të modeleve me anë të programeve të kompjuterike.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të realizojë kallëpet në letër/program;
2. Të zbatojë sistemin e koordinatave, në modelim;
3. Të zbatojë mënyrën e zhvillimit të zmadhimit/zvogëlimit të elementëve të kallëpeve në letër/program;
5. Të vendosë shenjat orientuese mbi kallëpet e zmadhuar/zvogëluar;
6. Të zbatojë teknikat e transferimit të masave të modelit;
7. Të evidentojë pikat e lëvizshme dhe të palëvizshme gjatë zhvillimit të numrave;
8. Të ndërtojë grafikisht zhvillimin e numrave në skemën e prerjes;

9. Të realizojë modelet me anë të programeve të kompjuterike;

Kriteret e vlerësimit

- Realizon kallëpe në letër/program, sipas skicës;
- Vendos shenjat orientuese mbi kallëpet e zmadhuar/zvogëluar, sipas skicës;
- Pret kallëpet e zmadhuara/zvogëluara sipas teknikës përkatëse.
- Zbaton saktë teknikat e transferimit të masave të modelit;
- Ndërton modele me anë të programeve të kompjuterike

D3-04-III-0090-24 Njohuri mbi modën dhe estetikën

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë estetikën e veshjes;
2. Të përshkruajë kodin e veshjeve;
3. Të shpjegojë karakteristikat estetike të veshjes për grupmosha të caktuara;
4. Të rendisë funksionin estetik dhe praktik të veshjeve;
5. Të përshkruajë estetikën e veshjeve popullore;
6. Të shpjegojë ndikimin e modës dhe estetikës në procesin e modelimit;
7. Të përshkruajë individualitetet, risitë dhe tendencat në modë në lidhje me modelimin;
8. Të përshkruajë zhvillimin historik të prerjes dhe modelimit të veshjes në periudha të ndryshme historike;
9. Të përshkruajë zhvillimin bashkëkohor të prerjes dhe modelimit të veshjeve;
10. Të përshkruajë linjat kryesore të fustaneve, “A”, “H”, “T”, “I”, “V”, “X”, “Y”, linja trapez, linja trekëndësh, linja këmbanë, linja amforë, linja tullumbace, linja princeshë, linja asimetrike, linja sirenë etj.;
11. Të shpjegojë rëndësinë e ngjyrave në fushën e modës;
12. Të listojë ngjyrat e para, të dyta, të treta, ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta;
13. Të përshkruajë përshtatjen e ngjyrave në veshje sipas stinës.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të dallojë kodin e veshjeve;
2. Të përdorë risitë dhe tendencat e modës në prerje dhe modelim të veshjeve;
3. Të dallojë linjat kryesore të fustaneve, “A”, “H”, “T”, “I”, “V”, “X”, “Y”, linja trapez, linja trekëndësh, linja këmbanë, linja amforë, linja tullumbace, linja princeshë, linja asimetrike, linja sirenë etj.;
4. Të përshtatë ngjyrat sipas tendencës së modës dhe stinës;

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh llojin e veshjes, sipas kodit dhe aktivitetit përkatës;
- Përdor risitë dhe tendencat e modës në prerje dhe modelim të veshjeve, sipas kodit të veshjes dhe kërkesave të klientit;
- Përshtat ngjyrat e tendencës së modës, sipas kodit të veshjes dhe kërkesave të klientit;

D3-04-III-0091-24 Realizimi i prototipit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë zbërthimin e skicës në elementët e veshjes;
2. Të listojë teknikat e vendosjes së kallëpeve mbi tekstil;

3. Të përzgjedhë mënyrat e transferimit të kallëpeve mbi tekstil;
4. Të shpjegojë teknikat e prerjes së elementëve të veshjes/aksesorëve dhe mjetet përkatëse;
5. Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së makinave qepëse, sipas llojit, funksionit dhe përdorimit të tyre;
6. Të përshkruajë teknikat e qepjes;
7. Të shpjegojë rëndësinë e veshjes së prototipit në trup ose manekin;
8. Të shpjegojë teknikat e kryerjes së provës së qëndrimit të prototipit në trup ose manekin;
9. Të argumentojë rëndësinë e kryerjes së provës dhe përsëritjes së saj;
10. Të listojë llojet e manekinave;
11. Të listojë llojet e problemeve të përshtatjes së modelit me trupin;
12. Të listojë llojet e defekteve në veshje pas provës;
13. Të listojë teknikat e korrigjimit të defekteve;
14. Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e dokumentimit të çdo ndryshimi ose rregullimi;
15. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e ekonomizimit të materialit;
16. Të përshkruajë rëndësinë e skedës teknike dhe elementët e saj.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbërthejë skicën në elementët e veshjes;
2. Të zbatojë teknikat e vendosjes së kallëpeve mbi tekstil;
3. Të përzgjedhë mënyrat e transferimit të kallëpeve mbi tekstil;
4. Të zbatojë teknikat e prerjes së elementëve të veshjes/aksesorëve me mjetet përkatëse;
5. Të përzgjedhë makinat qepëse, sipas llojit, funksionit dhe përdorimit të tyre;
6. Të përzgjedhë teknikat e qepjes;
7. Të zbatojë teknikën e veshjes së prototipit në trup ose manekin;
8. Të zbatojë teknikat e kryerjes së provës së qëndrimit të prototipit në trup ose manekin;
9. Të kryejë provën dhe përsëritjes së saj;
10. Të identifikojë problemet e përshtatjes së modelit me trupin;
11. Të përcaktojë defektet në veshje pas provës;
12. Të zbatojë teknikën e përzgjedhur për korrigjimin e defekteve;
13. Të dokumentojë ndryshimet ose rregullimet e realizuara;
14. Të zbatojë mënyrat e ekonomizimit të materialit;

Kriteret e vlerësimit

- Zbërthen elementët e modelit, sipas skicën/skedën teknike.
- Vendos dhe kopjon kallëpet në mënyrën e duhur mbi tekstil;
- Zbaton teknikat e prerjes së elementëve të veshjes/aksesorëve me mjetet përkatëse, sipas skicës;
- Përdor makinat qepëse të përzgjedhura sipas funksionit duke zbatuar manualët e përdorimit;
- Qep saktë elementët e veshjes/aksesorëve sipas teknikës së qepjes ose skedës teknike;;
- Kryen saktë provën e prototipit në trup ose manekin;
- Korrigjon defektet e identifikuar pas provës, në veshje;
- Dokumenton ndryshimet ose rregullimet e realizuara, sipas formateve;
- Ekonomizon materialit, sipas rregullit;

D3-04-III-0092-24 Konfeksionimi i produktit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e shtrimit të dyshekut të tekstilit për prerje;
2. Të shpjegojë teknikat e prerjes së materialit bazë dhe atyre ndihmëse;
3. Të shpjegojë llojet e proceseve përgatitore (qepjet e përkohshme, frazelini, filetimi, rrudhosja etj.);
4. Të shpjegojë teknikat e ndërtimit të elementëve të veshjes/aksesorëve (pencat, palat, mostrat, supanjat, xhepat, hapjet e qafës, jakat, mëngët, qemerët, kapakët etj.);
5. Të shpjegojë teknikat e bashkimit të elementëve të veshjes/aksesorëve;
6. Të shpjegojë proceset përfundimtare (tegela zbukurues, bira, kopsa, pala, zinxhirë dhe mbyllës të tjerë, zbukurime etj.) në varësi të modelit;
7. Të shpjegojë mjetet dhe teknikat e hekurosjes;
8. Të përshkruajë llojet e etiketimeve, elementët, mënyrat dhe teknikat e realizimit të tij;
9. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e paketimit dhe ambalazhimit, si dhe mjeteve përkatëse të tyre;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë teknikat e shtrimit të dyshekut të tekstilit për prerje;
2. Të zbatojë teknikat e prerjes së materialit bazë dhe atyre ndihmëse;
3. Të realizojë proceset përgatitore (qepjet e përkohshme, frazelini, filetimi, rrudhosja etj.);
4. Të zbatojë teknikat e ndërtimit të elementëve të veshjes/aksesorëve (pencat, palat, mostrat, supanjat, xhepat, hapjet e qafës, jakat, mëngët, qemerët, kapakët etj.);
5. Të zbatojë teknikat e bashkimit të elementëve të veshjes/aksesorëve;
6. Të realizojë proceset përfundimtare (tegela zbukurues, bira, kopsa, pala, zinxhirë dhe mbyllës të tjerë, zbukurime etj.) në varësi të modelit;
7. Të zbatojë teknikat e hekurosjes me mjetet përkatëse;
8. Të zbatojë teknikat dhe mënyrat e etiketimeve;
9. Të realizojë paketimin dhe ambalazhimin e produktit të konfeksionuar me mjeteve përkatëse;

Kriteret e vlerësimit

- Shtron dyshekun e tekstilit për prerje sipas teknikave përkatëse;
- Vendos kallëpet mbi tekstil/dyshek në mënyrën e duhur;
- Zbaton teknikat e prerjes së saktë të materialeve bazë dhe ndihmëse, me mjetet përkatëse, sipas skicës;
- Kryen procese përgatitore (frazelinim, filetim, rrudhosje etj.) në varësi të tekstilit dhe skicës së modelit;
- Zbaton saktë teknikat e ndërtimit të elementëve të veshjes/aksesorëve (pencat, palat, mostrat, supanjat, xhepat, hapjet e qafës, jakat, mëngët, qemerët, kapakët etj.);
- Bashkon elementë të veshjes/aksesorëve, sipas skicës;
- Kryen proceset përfundimtare (tegela zbukurues, bira, kopsa, pala, zinxhirë dhe mbyllës të tjerë, zbukurime etj.) sipas modelit;
- Zbaton teknikat e hekurosjes, sipas llojit të materialit, me mjetet përkatëse;
- Zbaton teknikat dhe mënyrat e etiketimeve sipas llojit të materialit dhe produktit;
- Realizon paketimin dhe ambalazhimin e produktit të konfeksionuar me mjeteve përkatëse sipas rregullave të paracaktuara;

D3-04-III-0093-24 Kryerja e kontrollit të cilësisë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e masave të marra;
2. Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e kontrollit të saktësisë së kallëpeve bazë;
3. Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e kontrollit të saktësisë së transferimit të kallëpeve nga letra në tekstil dhe anasjelltas;
4. Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e kontrollit të saktësisë së kallëpeve të modeluara;
5. Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e kontrollit të saktësisë së vendosjes së shenjave orientuese;
6. Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e kontrollit të saktësisë së zmadhimit/zvogëlimit të kryer;
7. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të saktësisë në vendosjen së kallëpeve në material;
8. Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e kontrollit të saktësisë së prerjes së materialeve;
9. Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e kontrollit të saktësisë së qepjes së elementëve;
10. Të shpjegojë rëndësinë e realizimit të kontrollit të produktit përfundimtar.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të verifikojë masat e marra;
2. Të kontrollojë saktësinë e kallëpeve bazë;
3. Të kontrollojë saktësinë e transferimit të kallëpeve nga letra në tekstil dhe anasjelltas;
4. Të kontrollojë vizualisht ose nëpërmjet krahasimit saktësinë e kallëpit të modeluar;
5. Të kontrollojë saktësinë e vendosjes së shenjave orientuese;
6. Të kontrollojë saktësinë e zmadhimit/zvogëlimit të kryer;
7. Të kontrollojë saktësinë e vendosjes së kallëpeve në material;
8. Të kontrollojë saktësinë e prerjes së materialeve;
9. Të kontrollojë saktësinë e qepjes së elementëve;
10. Të kontrollojë produktin përfundimtar.

Kriteret e vlerësimit

- Verifikon masat e marra;
- Kontrollon saktësinë e kallëpeve në stadi të ndryshme të ndërtimit të tij, sipas teknikës përkatëse;
- Kontroll saktësinë e transferimit të kallëpeve nga letra në tekstil;
- Kontrollon vizualisht ose nëpërmjet krahasimit saktësinë e kallëpit të modeluar;
- Kontrollon vizualisht ose nëpërmjet krahasimit saktësinë e vendosjes së shenjave orientuese;
- Kontrollon saktësinë e zmadhimit/zvogëlimit të kryer sipas teknikës përkatëse (vizuale, me vegla matëse ose digjitale etj.);
- Kontrollon saktësinë e prerjes së materialeve;
- Kontrollon saktësinë e qepjes së elementëve;
- Kontrollon produktin përfundimtar sipas rregullave të paracaktuara.

D3-32-III-0013-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
2. Të përshkruajë rëndësinë e një plan biznesi;

3. Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
4. Të analizojë interesat, zotësitë dhe aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme
5. përfshirë dhe vetëvlerësimin;
6. Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
7. Të shpjegojë rëndësinë e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
8. Të evidentojë llojet e literaturës bashkëkohore;
9. Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtjshme;
10. Të për zgjedhë llojet e trajnimeve, konferencave, kurseve teknike;
11. Të shpjegojë rëndësinë e pjesëmarrjes në panairë dhe ekspozita;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një ide sipërmarrëse;
2. Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
3. Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet;
4. Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe për biznes, njohuritë e mëparshme..) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
5. Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
6. Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës;
7. Të zbatojë Kodin e punës për organizimin dhe funksionimin e një biznesi;
8. Të realizojë një plan të thjeshtë biznesi;
9. Të llogaritë nevojën për materialet e nevojshme;
10. Të hartojë grafikun e punës;
11. Të regjistrojë të dhënat për faturat;
12. Të raportojë te eprorët në kohën e duhura;
13. Të informohet mbi çmimet e tregut dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve bazuar në standardet e prodhimit të veshjeve;
14. Të llogarisë kostot e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe çmimin e një produkti;
15. Të përgatisë një oferte për produktet që do të realizojë;
16. Të përdorë teknika të marketingut;
17. Të zbatojë ligjet dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave të klientit;
18. Të zbatojë ligjin e të drejtave të pronësisë intelektuale, të drejtave të autorit dhe markave tregtare;
19. Të zgjedhë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
20. Të për zgjedhë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin “Modelist”;
21. Të transmetojë në kohë tek bashkëpunëtorët njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
22. Të marrë pjesë në panairë dhe ekspozita;
23. Të marrë pjesë në sfilata dhe konkurse të ndryshme;
24. Të marrë pjesë në trajnime dhe kurse teknike.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton me korrektësi legjislacionin tatimor, doganor, kodin e punës dhe legjislacionin në fushën e lidhur me aktivitetin që kryen;
- Realizon një plan të thjeshtë biznesi, sipas kërkesës;
- Realizon saktë planet ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat dhe llojit të produkteve;
- Regjistron saktë të dhënat për ofertat dhe faturat e lëshuara klientëve;
- Informohet me çmimet e tregut dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
- Llogarit kostot e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe produkteve të realizuara në bazë të projektit të dhënë;
- Kryen blerje të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve sipas nevojave dhe standardit të synuar;
- Llogarit çmimin përfundimtar për produktet e ofruara;
- Respekton dhe zbaton ligjet në fuqi në fushën e modës
- Bashkëpunon për ngritjen e tij profesionale

D3-31-III-0014-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë parimet bazë të komunikimit dhe metodat e tij;
2. Të përshkruajë mënyrat e mikpritjes së klientit dhe komunikimit me të;
3. Të listojë teknikat e promovimit, reklamimit, këshillimit dhe informimit të klientit;
4. Të shpjegojë rëndësinë e informimit të klientit rreth produkteve/shërbimeve;
5. Të përshkruajë parimet e punës në grup;
6. Të shpjegojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
7. Të shpjegojë rëndësinë e kodit të etikës;
8. Të listojë llojet e metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
9. Të shpjegojë mënyrat e dhënies dhe marrjes së udhëzimeve nga bashkëpunëtorë për
10. realizimin e detyrës;
11. Të përshkruajë rregullat e komunikimit me eprorët dhe kolegët duke përdorur
12. terminologji të qartë;
13. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK-³ut në komunikimin me të tjerët;
14. Të shpjegojë mënyrat e zbatimit të teknologjive të reja të komunikimit;
15. Të argumentojë rëndësinë e zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve me klientët;
16. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale dhe në gjuhë të huaj;
17. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë metodat e komunikimit verbal dhe jo verbal;
2. Të zbatojë parimet e punës në grup;
3. Të komunikojë saktë dhe në mënyrë profesionale me klientët, furnitorët dhe bashkëpunëtorët;
4. Të plotësojë kërkesat e porosisë së klientit brenda afatit të përcaktuar;
5. Të vendosë prioritete në punën e përditshme;

³ Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit

6. Të zbatojë kodin e etikës;
7. Të zbatojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
8. Të përdorë TIK në komunikimin me të tjerët;
9. Të përdorë terminologji profesionale;
10. Të respektojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal me klientët dhe bashkëpunëtorët
- Zbaton kodin e punës dhe kodin etik;
- Zbaton teknologjitë e reja për të arritur një komunikim të shpejtë me të tjerët duke u përshtatur me to;
- Zgjidh ankesat dhe mosmarrëveshjet me klientët;
- Përdor teknika të ndryshme marketingu;

D3-04-III-0094-24 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë;
2. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të Standardit ndërkombëtar, të standardeve dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik;
3. Të përshkruajë manualët për përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
4. Të shpjegojë mënyrën e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti sipas procedurës.
5. Të shpjegojë planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive.
6. Të përshkruajë përdorimin e pajisjeve të MZSH4;
7. Të shpjegojë masat përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
8. Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e ndryshme të riciklimit të mbetjeve teknologjike
9. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të duhura në raste pandemie;
10. Të shpjegojë përdorimin në mënyrë racionale të energjisë dhe materialeve sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm;
11. Të shpjegojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
12. Të përshkruajë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
13. Të shpjegojë rëndësinë e veprimtarive praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor;

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë Standardin ndërkombëtar, standardet dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik;
2. Të zbatojë manualët për përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të improvizojë dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti sipas procedurës;
4. Të improvizojë zbatimin e planit të evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive;
5. Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse
6. Të zbatojë masat përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
7. Të zbatojë mënyrat e ndryshme të riciklimit të mbetjeve teknologjike

⁴ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi

8. Të zbatojë protokollet e duhura në raste pandemie;
9. Të respektojë parimet zhvillimit të qëndrueshëm për përdorimin në mënyrë racionale të energjisë dhe materialeve të ndryshme;
10. Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
11. Të kryejë ndarjen e mbetjeve në mjedis;
12. Të përdorë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore;
13. Të zbatojë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
14. Të realizojë veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit vendor;

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton rregullat e sigurimit teknik;
 - Zbaton standardet dhe legjislacionin në fuqi;
 - Zbaton manualët e përdorimit të pajisjeve të punës;
 - Zbaton rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse;
 - Zbaton masat përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
 - Zbaton mënyrat e ndryshme të riciklimit të mbetjeve teknologjike;
 - Zbaton protokollet e duhura në raste pandemie;
 - Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit;
- Realizon veprimtari praktike për mbrojtjen e mjedisit;

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në modelim	10	D3-04-III-0087-24
2	Marrja e masave dhe përgatitja e kallëpeve	5	D3-04-III-0088-24
3	Zhvillimi i kallëpeve në masa të tjera	10	D3-04-III-0089-24
4	Njohuri mbi modën dhe estetikën	10	D3-04-III-0090-24
5	Realizimi i prototipit	20	D3-04-III-0091-24
6	Konfeksionimi i produktit	25	D3-04-III-0092-24
7	Kryerja e kontrollit të cilësisë	5	D3-04-III-0093-24
8	Sipërmarrja dhe edukim karriere	5	D3-32-III-0013-24
9	Komunikimi dhe etika profesionale	5	D3-31-III-0014-24
10	Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit	5	D3-04-III-0094-24
Total		100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për

kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të specifikuar.

Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit. Individi i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- d) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- e) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- f) formave të tjera të përcaktuara me ligj

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **K-D3-III-24**

K - Kualifikim

D - Shkronja që identifikon drejtimin e kualifikimit

3 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

III - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **D3-04-III-0087-24**

D3 - Shkronja që identifikon drejtimin dhe profilin e kualifikimit

04 - Numri që identifikon orientimin e Njësisë së të Nxënit

III - Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0087 - Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

24 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit